



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1764/5 prot.

Datë 10.07.2025

V E N D I M

Nr. 886/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.07.2025 me

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “AEE SERVICE” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”- Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ku për secilin lot do të shpallet një operator ekonomik fitues.”, me Nr. REF-50051-06-03-2025, me objekt: Loti 2: “Mirëmbajtje automjete për Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë”, me fond limit 5,500,000 (pesë milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH zhvilluar më datë 16.06.2025, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Ankimues: Operatori ekonomik “AEE SERVICE” SHPK, me Nipt. L81530012C Adresa: Rruga dytësore, mbikalimi i Kasharit, objekt në zonën kadastrale 2105, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a
Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,

Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04.06.2025, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”-Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ku për secilin lot do të shpallet një operator ekonomik fitues.”, me Nr. REF-50051-06-03-2025, me objekt: Loti 2: “Mirëmbajtje automjete për Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë”, me fond limit 5,500,000 (pesë milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH zhvilluar më datë 16.06.2025, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

II.2. Në datën 16.06.2025, Operatori i Blerjeve të Përqendruara zhvilloi procedurën e prokurimit objekt ankimi .

II.3. Në datën 30.06.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sisimit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, përkatësisht:

1. OE “Vilnik MOTORS” shpk	me vlerë 4,124,000 lekë	skualifikuar
2. OE “Penta Group Albania” shpk	me vlerë 5,291,000 lekë	skualifikuar
3. OE “AEE SERVICE” shpk	me vlerë 5,445,000 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 01.07.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e anulimit të procedurës së prokurimit.

II.5. Në datën 03.07.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5516 dhe me Nr. 1764/2025 Prot., datë 03.07.2025 e operatorit “AEE SERVICE” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij.

II.6. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 1764/1 prot., datë 04.07.2025, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “AEE SERVICE” SHPK kundërshton me anë të ankesës, nr. 1764/2025 Prot., datë 03.07.2025.

II.7. Në datën 09.07.2025, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1764/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 1740/11 prot., datë 08.07.2025, me objekt: *“Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “AEE SERVICE” SHPK lidhur me vlerësimin e procedurës së prokurimit me nr. REF-50051-06-03-2025, me objekt: Loti 2: “Mirëmbajtje automjete për Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë”, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik dhe operatorit ekonomik “AEE SERVICE” SHPK”, bashkëngjitur Vendimi i KSHA-së me nr. 66/2025 prot., datë 08.07.2025. Referuar këtij vendimi rezulton, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, e ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik “AEE SERVICE” SHPK.*

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113, ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, për spëmbushje të kriterëve të kualifikimit nga ana e operatorit ekonomik “AEE SERVICE” SHPK” në procedurën e mësipërme të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar Vendimit të KSHA-së me nr. 66/2025 prot., datë 08.07.2025.2024, bashkëngjitur shkresës së autoritetit kontraktor me nr. 1740/11 prot., datë 08.07.2025, me objekt: “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “AEE SERVICE” SHPK REF-50051-06-03-2025, me objekt: Loti 2: “Mirëmbajtje automjete për Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë”, rezulton, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, e ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik “AEE SERVICE” SHPK”.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se:

Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se:

1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

- a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;
- b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.4. Sa më sipër, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimi i shkresës nr.1740/11 prot., datë 08.07.2025, me objekt: “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “AEE SERVICE” SHPK REF-50051-06-03-2025, me objekt: Loti 2:“Mirëmbajtje automjete për Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë”,, të dorëzuar pranë KPP-së në datë 09.07.2025, nga autoriteti kontraktor, ku konstatohet se ky i fundit, ka vendosur pranim plotësisht të ankesës së operatorit ekonomik “ AEE SERVICE” SHPK si dhe referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ nga ku rezulton, se nuk janë paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik argumente në kuptim të nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “AEE SERVICE” SHPK,, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”-Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ku për secilin lot do të shpallet një operator ekonomik fitues”, me Nr. REF-50051-06-03-2025, me objekt: Loti 2:“Mirëmbajtje automjete për Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë”, me fond limit 5,500,000 (pesë milion e pesëqind mijë)lekë pa TVSH zhvilluar më datë 16.06.2025, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar duke kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit në zbatim të vendimit të KSHA-së.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “AEE SERVICE” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

